



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 28, datë 11.09.2018

MBI

“PROPOZIMIN PËR MIRATIM, PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË 2 STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018 ”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03. 2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”; kreun VI/2 të Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018” (i ndryshuar); urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 2, datë 14.02.2018 mbi “Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018, në Universitetin e Arteve” shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2921 prot, datë 19.03.2018 “Për vlerësimin me prioritet të studentëve të kategorive sociale në nevojë, si dhe studentëve të ekscelencës që ndjekin studimet në vitin akademik 2017-2018”; si dhe në Relacionin e Grupit të Punës me nr. 340.prot, datë 03.05.2018 “Mbi materialin e përgatitur, nga grupi i punës, për studentët e ciklit të parë me kohë të plotë, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit dhe reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët e ciklit të dytë me kohë të plotë, në Fakultetet e Universitetit të Arteve” dhe proces verbalit të Grupit të Punës me nr. 340/1 prot. datë 21.05.2018, pasi e diskutoi,

VENDOSI:

1. Propozimin për miratimin, për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të 2 studentëve (Erola Cela dhe Vashë Musa) të Fakultetit të Arteve të Bukura, të cilët bazuar nga proces verbalit i Grupit të Punës me nr. 340/1 prot. datë 21.05.2018 kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në lidhje me ekzaminimin e sëmundjes së tyre nga komisioni mjeko ligjor (bashklidhur vendimit).
2. Ky vendim ti paraqitet Bordit të Administrimit të Uart për miratimin përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK
SEKRETARIATI TEKNIK**



Nr. Prot.

Tiranë, më 11.09.2018

RELACION

Lënda: MBI "PROPOZIMIN PËR MIRATIM, PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË 2 STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018"

Të nderuar Anëtarë të Senatit Akademik,

Bazuar në proces verbalin e Grupit të Punës me nr. 340/1 prot. datë 21.05.2018 (bashklidhur vendimit) sipas detyrave të lëna nga Bordi i Administrimit, kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në lidhje me ekzaminimin e sëmundjes së tyre nga komisioni mjeko ligjor, 2 studentë (Erolda Cela dhe Vashë Musa) të Fakultetit të Arteve të Bukura për të përfituar përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018. Nga verifikimi rezulton se këta studentë janë ekzaminuar me sëmundjet përkatëse, pas konkursit të zhvilluar për regjistrim në UART.

Për sa më sipër po Ju dërgojmë bashklidhur këtij Relacioni dokumentacionin e dorëzuar nga studentët e mësipërm.

SEKRETARIATI TEKNIK I SENATIT AKADEMIK

Msc. Elia PLAKU

DREJTOR MBNJ

Msc. Ted KAMBERI

PERGJ.SEK.JURIDIK



Nr. 390/prot.

Tiranë, më 21.05.2018

Proces verbal

I mbajtur në datën 21.05.2018 në lidhje me pikën 4 të Relacionit të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 7, datë 21.05.2018

Grupi i punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018, në Universitetin e Arteve:

1. Pas diskutimeve të anëtarëve të Bordit të Administrimit, i cili me vendimin e tij nr. 7, datë 21.05.2018 pika 1, përcakton përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët e ciklit të parë mbështetur në relacionin e përpiluar (nga grupi i punës).
2. Grupi i Punës në pikën 4 të këtij Relacioni nuk prejashtoi një grup studentësh të cilët nuk kanë aplikuar sipas Kreut VI/2 pika 1, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018" (i ndryshuar me udhëzimin nr. 18., datë 16.08.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin me nr. 15, datë 19.05.2017) dhe për këtë pikë Bordi i Administrimit u shpreh se:
 - 3 studentët të cilët aplikojnë nga shtresa e komunitet Rom/Egjyptian... nuk përfitojnë nga Vendimi i Bordit të Administrimit, përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit;
 - 2 studentë të cilët kanë aplikuar nga shtresa me aftësi të kufizuara..., nuk përfitojnë nga Vendimi i Bordit, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, nëse data e ekzaminimit të sëmundjes së tyre është para konkursit për tu futur si studentë në UART. Nëse këta studentë sjellin të dokumentuar nga Mjeku i tyre që ekzamini i sëmundjes është bërë pas konkursit për tu futur në UART, atëherë do të rishihen dokumentat e dorëzuara dhe do shqyrtohen sipas akteve administrative të Uart në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit të UART.

Grupi i punës:

Ted Kamberi

Elia Plaku

Jeta Shashaj